

## **POLICA E SIGURIMIT TE JAHTEVE**

### **KLAUZOLAT E SIGURIMIT**

Këto klauzola, së bashku me Çertifikatën dhe çdo shtojcë të aplikuar, përbëjnë kushtet e përgjithshme për të cilat Siguruesi ka rënë dakord për të siguruar Jahtin. Këto dokumente do të lexohen të gjitha së bashku si një e tërë.

#### **1. Dëmi fizik**

Jahti sigurohet deri në vlerën e deklaruar në Çertifikatë kundrejt të gjithë rreziqeve të humbjeve apo dëmtimeve fizike që shkaktohen nga aksidente që përfshijnë edhe vjedhjen, defekte të trashëguara apo veprime neglizhente apo të qëllimshme të çdo personi, me kusht që këto veprime neglizhente apo të qëllimshme si edhe humbjet apo dëmet që lindin prej tyre do të ndodhin gjatë periudhës së mbuluar nga ky siguracion vetëm në varësi të përjashtimeve dhe përcaktimeve të vendosura në seksionet e mëposhtëm të këtyre Klauzolave.

Nëse, si rezultat i një ngjarjeje të siguruar, jahti ka humbje totale apo është dëmtuar aq shumë sa kostot për ta kthyer në gjendjen e mëparshme apo të riparimit të tij do të kalonin vlerën e deklaruar në Çertifikatë, ne do të paguanim vlerën e deklaruar në Çertifikatë ose, nëse ne vendosim ndryshe, do ta zëvendësonim atë me një mjet të ngjashëm të të njejtit tip dhe në kushte të njejta.

Në rast se jahti është dëmtuar si rezultat i një ngjarjeje të siguruar, Siguruesi do të paguajë shpenzimet e arsyeshme të riparimit të tij ose, nëse Siguruesi vendos ndryshe, do të zëvendësojë çdo pjesë të veçantë të humbur apo dëmtuar me një tip të ngjashëm me kushte të njejta.

Siguruesi do të paguajë kërkesat për dëmshpërblim në rastet kur ato bëhen si rezultat i një ngjarjeje të siguruar, përgjegjësia e Siguruesit sipas klauzoles 1.1 – 1.3 më sipër. Por përgjegjësia totale sipas klauzoles 1.4.1, 1.4.2 dhe 1.4.3 që lind nga një ngjarje e siguruar, në asnjë rast nuk do të kalojë një shumë të barabartë me vlerën e jahtit të deklaruar në Çertifikatë:

Kostot e arsyeshme të shpëtimit të anijes (përveç shërbimeve të shpëtimit që bëhen nga një anije tjetër me të njejtin pronar apo menaxhim).

Kostot e arsyeshme për heqjen e mbeturinave të anijes prej vendit nga i cili i Siguruari bëhet ligjërisht i detyruar ta lëvizë atë dhe shpenzimet e arsyeshme për zhvendosjen e anijes së mbytur.

Shpenzimet e arsyeshme për të inspektuar fundin e jahtit pas rënies në cekinë, nëse kryhen në mënyrë të arsyeshme si rezultat i kesaj rënieje në cekinë, bile edhe nëse nuk është gjetur asnjë dëmtim.

## 2 PERGJEGJESIA

- 2.1 Në varësi të përjashtimeve dhe cilësimeve të deklaruara në seksionet e mëposhtëm të kësaj klauzole, Siguruesi do të mbulojë të Siguruarin, si dhe këdo që ka në kontroll jahtin me lejen e të Siguruarit, kundrejt të gjitha përgjegjësive ndaj palëve të treta si rezultat i pronësisë apo kontrollit të jahtit, deri në shumën kufi të përgjegjësisë ndaj Palëve të Treta të deklaruar në Çertifikatë.
- 2.2 Siguruesi, si shtesë të shumës së deklaruar më sipër, do të paguajë edhe shpenzimet gjyqësore që bëhen me miratimin e Siguruesit për mbrojtjen ose ndjekjen e çdo procedure gjyqësore që rrjedhin nga apo në lidhje me një ngjarje që bën të lindë përgjegjësia e cila mbulohet nga ky Seksion.
- 2.3 Siguruesi do të emërohet të marrë përsipër të drejtojë çdo procedurë ligjore që mbulohet sipas klauzolës 2.2 në emër të çdo personi të mbuluar në Seksionin 2 dhe të gjithë këta persona duhet të bashkëpunojnë tërësisht me Siguruesin në ndjekjen dhe/ose mbrojtjen e këtyre proceseve.

## 3 AKSIDENTET PERSONALE

(Ky Seksion zbatohet vetëm kur anija përdoret për qëllim privat dhe jo për biznes)

- a. Ky Seksion mbulon të siguruarin, dhe çdo person që ndodhet në bordin e anijes me lejen e të siguruarit, vetëm kur anija përdoret për qëllime private, për kënaqësi.
- b. Siguruesi do të paguajë të Siguruarin apo Administratorët e tij për shumën e deklaruar në Çertifikatë nëse gjatë periudhës së mbulimit të këtij siguracioni i Siguruarit pëson një plagosje trupore aksidentale ndërsa është në bordin e jahtit ose gjatë imbarkimit apo disimbarkimit nga jahti në breg apo përmes një motorskafi shërbimi me motor që nuk kalon 5 KF i cili, vetëm dhe pavarësisht nga ndonjë arsye tjetër, rezulton me vdekjen apo paaftësinë e të Siguruarit, sipas kushteve të specifikuara në Tabelën e Kompensimeve, brenda 12 muajve kalendarikë të aksidentit duke shkaktuar plagosje.

### Tabela e Kompensimeve

(Vdekja, humbja e një ose me shumë gjymtyrëve, humbja e shikimit në një apo dy sytë, apo paaftësia totale e përhershme) siç tregohet në Çertifikatë.

- 3.1 Në raste të kërkesës për dëmshpërblim që lind si pasojë e një aksidenti ku përfshihen më shumë se 6 persona, shuma individuale e siguruar do të reduktohet proporcionalisht deri sa shuma totale nuk do të kalojë kufirin e shumës së treguar në Çertifikatë në seksionin „Aksidente Personale“.

- 3.2 Për fëmijë nën 16 vjeç në datën e vdekjes, përfitimi i pagueshëm në lidhje me vdekjen është i kufizuar në shumën prej 4000 EURO apo ekuivalenti në monedha të tjera.
- 3.3 Në Seksionin 3 do të zbatohen përcaktimet e mëposhtëme:
- 3.3.1 "Humbja e gjymtyrës" nënkupton humbjen e përhershme me ndarje fizike të një dore mbi brryl apo të një këmbë mbi gju dhe përfshin humbjen totale dhe të pakthyeshme të përdorimit të një gjymtyre.
- 3.3.2 "E përhershme" nënkupton zgjatjen për 12 muaj kalendarikë në vazhdim kur në fund të kësaj periudhe i Siguruari është pa shpresë për përmirësim.
- 3.3.3 "Paaftësi totale" nënkupton paaftësinë e cila ndalon të Siguararin të angazhohet në punët e zakonshme.
- 3.4 Siguruesi nuk do të paguajë kërkesa për dëmshpërblim që përfshijnë më shumë se një titull në Tabelën e Kompensimeve në lidhje me çdo një aksident. Në rastet kur një aksident shkakton paaftësi i cili pasohet me vdekje që ndodh nga çdo shkak, brenda 12 muajve kalendarikë të ndodhjes së aksidentit, Siguruesi do të paguajë vetëm kompensimin e pagueshëm në rast vdekjeje.
- 3.5 Në rast të një kërkesë për dëmshpërblim që lind në përputhje me Seksionin 3, i Siguruari bie dakord të pranojë ekzaminim nga mjekët e Siguruesit sa shpesh ta shohë ai të arsyeshme.
- 3.6 Siguruesi nuk është përgjegjës sipas Seksionit 3 për:
- 3.6.1 Për vdekje apo paaftësi për persona që kanë arritur 70 vjeç në datën e fillimit të këtij sigurimi.
- 3.6.2 Për vdekje apo paaftësi të personave që ndodhen në bordin e jahtit si rezultat i një kontrate punësimi, apo për tregëti, profesion apo biznes.
- 3.6.3 Për vdekje apo paaftësi që direkt apo indirekt lind nga sëmundje me shkaqe natyrore apo trajtime kirurgjikale (përveç kur bëhet e nevojshme nga një aksident i mbuluar nga ky Seksion 3) apo vetëvrasje ose përpjekje për vetëvrasje apo përpjekje për vetplagosje apo ekspozim i qëllimshëm për ndonjë risk të veçantë (përveç gjatë përpjekjeve për shpëtimin e jetëve njerëzore) apo për një veprim kriminal të të Siguararit.
- 3.6.4 Për vdekje apo paaftësi të cilat direkt apo indirekt lindin prej luftës, invazionit apo luftës civile.
- 3.6.5 Për vdekje apo paaftësi që ndodhin ndërsa jahti është përdorur për qëllime të tjera përveç për përdorimit privat, për kënaqsi.

#### 4 PERJASHTIME QE LIDHEN ME SEKSIONIN 1 (DEME FIZIKE)

Siguruesi nuk do të paguajë kërkesat për dëmshpërblim për:

- a. Për çdo humbje apo dëm që shkaktohet nga mosushtrimi i domosdoshem i menaxhimit të jahtit siç duhet apo mosmbajtja e tij në kushte të përshtatshme lundrimi ndërsa është për faj të të Siguruarit, kapitenit të jahtit apo i ndonje personi tjetër i caktuar nga i Siguruari për të menaxhuar jahtin.
- b. Për çdo humbje apo dëm të shkaktuar me qëllim nga i Siguruari apo nga çdokush në bordin e jahtin me lejen e të Siguruarit.
- c. Për çdo humbje apo dëmtim të shkaktuar nga vjetrimi, korrozioni, sjellja e brendëshme, mikrobet apo dëmet nga ngrirja.
- d. Për shpenzimet e riparimit ose zëvendësimit të çdo pjese të jahtit që ka rezultuar me defekt latent (megjithatë Siguruesi do të paguajë për dëme të shkaktuara në pjesën tjetër të jahtit nga dëmtimi i papritur dhe i menjëhershëm i kësaj pjese).
- e. Për vjedhje apo lëvizje të paautorizuar të jahtit nga çdokush i cili kontrollon jahtin me lejen e të Siguruarit përveç kapitenit profesionist apo ekuipazhit.
- f. Për vjedhje të çdo motori jashtëbordi i cili në kohën kur ndodh vjedhja ishte:
  - i. I siguruar në jaht nga disa mënyra përveç atyre të domosdoshme dhe ka shenja të dukshme të lëvizjes me forcë; ose
  - ii. Brenda një kabine apo magazine të kyçur në të cilin ka shenja të dukshme të hyrjes me forcë.
- g. Për vjedhje të çdo ingranazhi apo pajisjeje përveç kur në kohën e vjedhjes pjesa ishte brenda kabinës apo një kompartamenti të kyçur, në bord ose në tokë, në të cilin ka shenja të dukshme të hyrjes me forcë.
- h. Për vjedhje të çdo varke apo motorskafi shërbimi në jaht, përveç kur është rregjistruar në emër dhe numër regjistrimi të veçantë.
- i. Për pjesën e zbritëshme të vendosur në Çertifikatën e sigurimit në lidhje me çdo një apo seri humbjesh që lindin nga çdo një apo seri ngjarjesh. Sidoqoftë, kërkesat për dëmshpërblim sipas Klauzoles 1.2 do të paguhet pa aplikuar pjesën e zbritëshme.
- j. Për humbje dhe dëme nga rimorkimi.
- k. Për humbje ose dëme në mbulesat mbrojtëse apo tek pëlhurat e velave shkaktuar nga era.
- l. Për humbje apo dëme në pëlhurat, direkët, pjesët e lëvizshme apo fikse të bigave apo çdo gjë që lidhet me to ndërsa jahti bën garë.

Nëse jahti i deklaruar në Formular është prodhuar për shpejtësi që i kalojnë 17 nyjet, Siguruesi nuk do të paguajë kërkesat për dëmshpërblim për rastet:

- 4.A që linden ndërsa jahti ka marre pjesë në gara apo prova që lidhen me to.
- 4.B që rezultojnë nga motori fuoribord i cili i bashkangjitet apo vihet mbi bord, nëse fuqia e motorit është llogaritur nga prodhuesi të jetë 65 kuaj-fuqi.
- 4.C ndërsa jahti është në kontrollin e një personi i cili, sipas njohurive tuaja, ndodhet nën ndikimin e pijes apo alkolit.
- 4.D që rezulton nga zjarri apo eksplozioni në bordin e jahtit që ka një dhomë motorri apo hapsirë për motorrin, përveç kur dhoma apo hapësira e motorit është e pajisur me sistem për fikjen e zjarrit i cili vepron automatikisht, apo ka kontrollin në pozicionin e drejtimit apo jashtë dhe bashkangjitur dhomës apo hapsirës së motorrit. Është kusht i këtij sigurimi që ky sistem i shuarjes së zjarrit të instalohet siç duhet, të mbahet në gjendje pune dhe t'i bëhet shërbim rregullisht në përputhje me rekomandimet e prodhuesit.
- 4.E për humbje apo dëme në timon, aks apo helikë, përveç kur shkaktohet nga kontakti me anije tjetër, një bankinë apo mol, kur jahti është mbytur apo fundosur në rrethana të cilat nuk janë të përjashtuara sipas Klauzoles 4.F
- 4.F për dëme të shaktuar nga apo që linden kur jahti kur takon në cekinë, mbytet, zhytet apo përplasat ndërsa rimorkiohet ose ankorohet në mënyrë të papritur në breg.

## 5. PERJASHTIME QË LIDHEN ME SEKSIONIN 2 (PERGJEGJESIA)

Siguruesi nuk do të pranojë kërkesa për dëmshpërblim për përgjegjësi që linden nga:

- 5.1 Çdo person i punësuar nga i Siguruari apo çdo person tjetër i mbuluar në Seksionin 2 që ka lidhje me jahtin
- 5.2 Çdo person në bordin e jahtit me qera, pagesë apo shpërblim
- 5.3 Çdo palë e tretë gjatë transportit në tokë
- 5.4 Çdo person që ka në kontroll jahtin për arsye të tjera përveç privatisht për kënaqsi
- 5.5 Siguruesi nuk do të paguajë kërkesa për dëmshpërblim për përgjegjësi që rrjedhin nga çdo person i angazhuar ne:
  - 5.1.1 ski-ujore
  - 5.1.2 ski që terhiqen me motorskaf
  - 5.1.3 akuaplan
  - 5.1.4 parashutë ujore
  - 5.1.5 apo aktivitete të ngjashme ndërsa ata janë duke u terhequr nga jahti ose duke u përgatitur për tërheqje, as për përgjegjësi që rrjedh nga persona të angazhuar jashtë jahtit në ndonje nga këto aktivitete
- 5.6 Siguruesi nuk do të paguajë kërkesa për dëmshpërblim për përgjegjësi të pranuar sipas ndonje kontrate.
- 5.7 Siguruesi nuk do të paguajë kërkesa për dëmshpërblim që rrjedhin nga çdo përgjegjësi e vendosur sipas një kontrate.

- 5.8 Siguruesi nuk do të paguajë kërkesa për dëmshpërblim për çdo gjobë apo dënim, as për çdo përgjegjësi për dëme të shumëfishuar, dëme të dënueshëm.
- 5.9 Siguruesi nuk do të paguajë kërkesa për dëmshpërblim për përgjegjësi nëse jahti i deklaruar në Çertifikatë, merr pjesë në gara apo teste shpejtësie apo në ngjarje që lidhen me to, si dhe ka një shpejtësi limit që kalon 17 njeje ndërsa është i ndezur.

## 6 KUSHTE TE PERGJITHSHME

### 6.1 Pyetsori

Pyetsori që plotëson dhe firmos i Siguruari apo agjenti ose menaxheri përbën bazën e kontrates midis tij dhe Siguruesit. I Siguruari garanton saktësinë e informacionit të deklaruar në pyetësor. Nëse ndonjë pjesë e informacionit është e pavërtetë apo e padeklaruar, Siguruesi ka të drejtë të ndërpresë këtë siguracion që prej fillimit të tij.

### 6.2 Lundrimi dhe Përdorimi

Jahti është i mbuluar me sigurim ndërsa lundron brenda kufijve të deklaruar në Çertifikatë, ndërsa është e ankoruar dhe rimorkjuar duke përfshirë ngritjen në shkallë apo lëshimin, ndërsa është duke lëvizur brenda dokut, gjatë pajisjes, përshtatjes, ripajisjes, kontrollit teknik, gjatë kryerjes se mirëmbajtjes apourvejimit special, por jo ndërsa është duke u përdorur për banim apo gjatë riparimeve të përgjithshme apo ndryshimeve. Timoni dhe pajisjet janë të mbuluara ndërsa ndodhen apo jo në bord të anijes, gjatë transportit nga vendi i ruajtjes në tokë apo ndërsa janë në vendin e ruajtjes në tokë.

### 6.3 Periudha

Ky siguracion është i vlefshëm për periudhën e treguar në Çertifikatë, përveç ndërprerjes apo përfundimit në përputhje me kushtet dhe në varësi të Klauzoles 6.8. Nëse Certifikata tregon një periudhë më të vogël se 12 muaj në vazhdim, në varësi edhe të kushteve të treguara në Çertifikatën e sigurimit, ky siguracion është i vlefshëm për këtë, periudhë me kusht që jahti të jetë allaj dhe jo i gatshëm për përdorim të menjëhershëm me të gjitha pjesët e lëvizshme dhe pajisjet si edhe sendet personale të kyçura në kabinë apo kompartiment të mbyllur.

### 6.4 Tranziti

Jahti është i mbuluar me sigurim ndërsa transportohet në rrugë tokësore, hekurudhë, traget apo rrugë ajrore, transport i cili fillon dhe mbaron në tokë, brenda kufijve gjeografikë të deklaruar në Çertifikatë dhe gjatë ngarkim shkarkimit. Siguruesi nuk do të paguajë kërkesë për dëmshpërblim që lind gjatë transportit për gërvishje, dalje boje apo çpime apo për çdo përgjegjësi për palët e treta. Nëse gjatësia e përgjithshme e jahtit është më shumë se 8.53 m, mbulimi me sigurim përfshin 16 km gjatësi rrugë tokësore dhe çdo transport do të kryhet nga një transportues profesionist, përndryshe nuk do të paguhet asnjë humbje apo dëm gjatë transportit.

- 6.5 Përdorimi Privat  
Jahti duhet të përdoret vetëm për qëllime private dhe në drejtimin e tij duhet të ketë persona kompetentë me miratim të të Siguruarit. Jahti nuk do të përdoret me qera apo hua, përveç kur është rënë dakord më parë që jahti do të përdoret për qëllime të tjera dhe Siguruesi ka rënë dakord të paguajë primin shtesë që kërkohet. Nëse bihet dakord sipas Klauzoles 6.5 që jahti mund të përdoret, jepet hua apo me qera, jahti duhet që gjatë gjithë kohës të jetë nën mbikqyrje nga një person i kualifikuar në mënyrë të mjaftueshme dhe duhet që gjatë gjithë kësaj kohe të jetë nën komandën e një personi kompetent.
- 6.6 Përdorimi në lundrim nga një dorë  
Jahti duhet që të lundroje vetëm midis orëve nga lindja e diellit deri në perëndim sipas orës lokale dhe vetëm për një total prej 50 milje në ditë, përveç rastit kur drejtohet të paktën nga dy persona të fortë fizikisht ku të paktën njëri është kompetent për të komanduar anijen.
- 6.7 Ndryshimi i pronësisë  
Në varësi të Klauzolës 6.8, ky siguracion do të ndërpritet menjëherë automatikisht me ndryshimin e pronësisë, ose nëse i Siguruar është Kompania, Trusti apo Korporata, ndryshimi në kontrollin e Kompanisë, Trustit apo Korporatës do të sjellë ndryshim të përfituesit ligjor.
- 6.8 Vazhdimësia e sigurimit  
Nëse jahti është në det kur perfundon siguracioni, mbulimi do të vazhdojë automatikisht derisa anija të prekë portin tjetër, me kusht që i Siguruari të njoftojë Siguruesin sa më shpejt të jetë e mundur dhe të pranojë të paguajë një prim shtesë që kërkohet.
- 6.9 Kujdesi i duhur  
I Siguruari dhe Menaxherët e tij (nëse ka) duhet që gjatë kohës të ushtrojnë kujdesin e duhur për të mbajtur jahtin në kushte të përshtatshme për lundrim, të shikojnë që jahti është pajisur siç duhet me të gjitha mjetet e sigurisë dhe t'i ruajë ato pajisje në gjendje të mirë pune si edhe të sigurohet që kur lihet pa ruajtje jahti është e brague mirë, që lokalet e akomodimit dhe të depozitimit janë të siguruar dhe të mbyllura si dhe të parandalojë ndotjen apo rrezikun e ndotjes si pasojë e dëmtimit të jahtit.
- 6.10 Ligjshmëria  
Eshtë kusht i këtij sigurimi që i Siguruari, dhe çdokush në komandën e jahtit, të jetë në përputhje me çdo ligj që ka lidhje me të, të sigurohet që jahti i përgjigjet çdo rregulli sigurie të aplikueshem dhe fiton çdo leje apo licensë të kërkuar me ligj, në çdo vend që ka juridiksion mbi ujrat në të cilat jahti lundron.
- 6.11 E re për të vjetër  
Siguruesi, sipas opinionit të tij, në rast të kërkesës për dëmshpërblim për zëvendësim të velave, mbulesave mbrojtëse, cimave apo motorëve jashtë bordit me vlerë më të madhe se dy të tretat e vlerës të secilës pjesë, mund t'i propozojë të Siguruarit të marrë një pjesë të re në vend të së vjetrës.
- 6.12 Procedura e kërkesës për dëmshpërblim  
Mosqenia në përputhje me kushtet e kësaj klauzole mund të paragjykojë kërkesën për dëmshpërblim.

- 6.12.1 Nëse një ngjarje bën të lindë një kërkesë për dëmshpërblim sipas çdo Seksioni të këtij siguracioni, i Siguruari duhet të njoftojë sa më shpejt të jetë e arsyeshme SIGAL Uniqa Group Austria sh.a.
- 6.12.2 Në rast vjedhjeje apo dëmi keqdashës i Siguruari duhet të njoftojë policinë lokale dhe autoritetet portuale sa më shpejt të jetë e mundur.
- 6.12.3 I Siguruari duhet të marrë të gjitha hapat e arsyeshëm për të ndaluar apo për të minimizuar çdo humbje që do të ishte e dëmshpërblyeshme sipas këtij siguracioni dhe të minimizojë përgjegjësinë ndaj palëve të treta. Në veçanti, i Siguruari nuk duhet të pranojë përgjegjësinë për operacione shpëtimi apo për çdo përgjegjësi në lidhje me të cilën ai është siguruar sipas Seksionit 6. Por edhe nëse i Siguruari bën të kundërtën, Siguruesi nuk do të jetë i detyruar për të dëmshpërblyer për operacionet e shpëtimit apo përgjegjësi të tjera. Si shtesë e shumës së paguar sipas këtij sigurimi, Siguruesi do të paguajë shpenzimet e arsyeshme të çdo hapi që i Siguruari do të marrë dhe që në përputhje me detyrimet e tij sipas Klauzolës 6.12.3 nuk kalojnë vlerën e jahtit. Shpenzimet e shpëtimit apo shpenzimet për mbrojtjen gjyqësore si edhe shpenzimet që bëhen nga i Siguruari për kundërshtimin e përgjegjësisë sipas Klauzolës 6.2 nuk mbulohen sipas kësaj Klauzole.
- 6.12.4 I siguruari duhet të bashkëpunojë plotësisht me Siguruesin për të siguruar informacionin dhe dëshmitë e duhura, dhe duhet të lejojë Siguruesin që të procedojë në emër të tij (por me shpenzimet e Siguruesit) për të fituar dëmshpërblim nga ndonjë palë e tretë në lidhje me mbulimet sipas këtij siguracioni.
- 6.12.5 Nëse i Siguruari bën një kërkesë për dëmshpërblim, apo deklaratë që ka lidhje me dëmshpërblimin, për të cilën Siguruesi ka dijeni që është fallco apo mashtruese, apo kur i Siguruari nuk furnizon me informacion në lidhje me një kërkesë për dëmshpërblim, ky siguracion do të bëhet i pavlefshëm që prej fillimit të tij dhe do të mbahet i gjithë primi i paguar.
- 6.12.6 Nëse kërkesa për dëmshpërblim është për koston e riparimit, i Siguruari duhet të sjellë të paktën dy kuotime për këto riparime.
- 6.12.7 Kërkesa për dëmshpërblim do të paguhet vetëm pasi të jetë bërë riparimi dhe i Siguruari ka bërë deklaratën e pranimit të vlerës.
- 6.13 Çdo njoftim i Siguruari duhet ta japë te SIGAL Uniqa Group Austria sh.a. në adresën zyrtare.
- 6.14 Përveç kur shprehet ndryshe në Çertifikatë, ky siguracion do të funksionojë në përputhje me ligjin Shqiptar.
- 6.15 Përveç kur shprehet ndryshe në Çertifikatë, ky siguracion është në varësi ekskluzive të juridiksionit të Gjykatës Shqiptare.